



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1299/Prot.
15

Patos, më 25/05 2026

PROCESVERBALI I TAKIMIT 22 MAJ 2026

Vendi: Njësia administrative Ruzhdië

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:00

Dëgjese publike me temë: “Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027.”

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 83, datë 17.12.2025 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027”.

Pjesëmarrës: Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Sekretare e Përgjithshme, znj. Juella Shpata, Anëtarë GMS, përfaqësues të bashkisë Patos, administrator i Ruzhdies, z. Agim Mesutaj, kryetarë të fshatrave me pjesëmarrjen e *10 pjesëmarrësve*.

Takimin hapet nga sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba- Të nderuar të pranishëm! Ju



**Sekretare e Këshillit
Znj. Refaela Xeba**

**Dëgjese publike me temë:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Tema e kësaj dëgjese është “Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”. Kjo dëgjese është e bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar,

ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 83, datë 17.12.2025 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027”. Presim kërkesa të tjera shtesë të njësive tuaj lidhur me hartimin e PBA-së dhe buxhetit.

Kryetar i Fshatit Siqecë, z. Myftar Sorraj- Siç e kemi thënë dhe herë tjetër ne kemi problem me ujin e pijshëm. 70% e popullatës në Siqec është pa ujë. Azhornimi i pronave është një tjetër problem në fshatin tonë pasi kemi 35 vjet që presim. Koshat e mbeturinave duhen vendosur në fshatin tonë. Kemi dhe problem me rrugët e parcelave të cilat duhen hapur. Kemi dhe rrugën kryesore në Siqecë nga ambulanca deri në qaf shkallëz që është prishur fare dhe duhet ndërhyrë për rregullim. Kjo rrugë është kryesore për qarkullimin e njerëzve.



**Kryetar i fshatit Siqecë
z. Myftar Sorraj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

Kryetar i fshatit Gjynoqarë, z. Nuri Gllava- Në Gjynoqarë kërkoj të vazhdojnë muret



**Kryetar i fshatit Gjynoqarë
z. Nuri Gllava**

**Dëgjesë publike me temë:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

mbajtës. Gjithashtu na duhen koshat e mbeturinave sepse nuk kemi ku të hedhim mbeturinat. Ne në Gjynoqarë kemi disa rrugë që janë dëmtuar për shkak të ndërhyrjeve që u bënë nga shtyllat elektriket. Rrugët janë bërë të pakalueshme. Sidomos rruga Gjynoqarë-Siqecë. Gjithashtu dhe rruga brenda për brenda fshatit. Kemi nevojë edhe për sabie për rrugët që të zënë vend sepse janë malore dhe nuk mbajnë. Ne kemi dhe vendburime natyrale që kërkon

komuniteti ti përdor, por ato duhen mirëmbajtur dhe kërkojmë nga ana juaj ndonjë rregullim për këto vendburime. Rrugët që janë në vazhdim ende kërkojmë të përfundojmë sa më shpejt.

Kryetar i fshatit Drenie, z. Shaban Lazaj- Unë si kryetar i fshatit Drenie kam disa probleme. Kemi problem me rrugët kryesore që kanë nevojë për rërë bituminoze, rrugët e



**Kryetar i fshatit Drenie
z. Shaban Lazaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”
Maj 2026**

parcelave duhen hapur dhe duhen shtruar me çakull sepse nuk kalojmë dot. Gjithashtu kemi kërkesë edhe për elektrikun pasi telat janë shumë të vjetër dhe nuk mbajnë linjën.

Administrator i njësisë Ruzhdie, z. Agim Mesutaj- Përsëritet! Problemet e njësisë Ruzhdie u përmendën pak a shumë. Kemi nevojë për traktorin për rrugët e arave për të ndërhyrë. Rrugët e brendshme të fshateve kanë një terren të vështirë dhe as çakulli as zhavori nuk mbajnë. Unë do ti mësoja faktin që më shumë të shtohet buxheti të rëra bituminoze që në ti bëjmë rrugët. Shtyllat elektrike që janë vendosur në anën kryesore të rrugës kanë dëmtuar rrugën dhe mjetet e rënda gjithashtu. Për sa i përket bujqësisë, duhet të ketë një numër të caktuar tumbinosh për njësinë Ruzhdie sepse kërkesat janë pafund, por ne duke ditur se sa tumbino kemi mund ti shpërndajmë aty ku ka më shumë nevojë. E njëjta gjë dhe për rërën bituminoze. Duhet të kemi një buxhet të caktuar për këto dhe të bëjmë shpërndarjen e tyre.



**Administrator i njësisë Ruzhdie
z. Agim Mesutaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”
Maj 2026**

Sekretare e Këshillit Bashkiak, znj. Refaela Xeba- Nëse nuk keni kërkesa të tjera e mbyllim këtë dëgjese publike.

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj



Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba

